

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 4

Kodi: 069

EDUKIMI PËR DEMOKRACINË DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje

Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNj), e miratuar me rekomandimin CM/Rec(2010), e promovon EQD/EDNj si mënyrën parësore për “të pajisur nxënësit me njohuri, shkathtësi e vlera, dhe për të zhvilluar qëndrimet dhe sjelljet e tyre”, në mënyrë që ata të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Përveç mësimdhënësve që luajnë një rol vital në këtë aspekt, Karta pranon rolin e palëve tjera në edukim dhe në komunitet, për të bashkuar përpjekjet drejt krijimit të institucioneve demokratike.

Në Kosovë, Korniza e Re Kurrikulare është e bazuar në kompetenca, njëra prej të cilave është kompetenca qytetare. Një situatë e tillë ka krijuar nevojën për të zbatuar metoda aktive të të nxënësve, të cilat kontribuojnë në pajisjen e nxënësve me njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të domosdoshme për bashkëjetesë në shoqëri të llojshme.

Edukimi për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut mbështetet në përvojën e KEC në programe të kësaj fushe. Në vitin 2013, KEC ishte organizatë partnere e shkollës “Mehmet Isai” nga Gjilani, si pjesëmarrëse në Akademinë për të Drejtat e Njeriut të Evropës Jug-lindore, e cila u organizua nga Këshilli i Evropës (CoE) dhe European Wergeland Centre (EWC). Ndërkaq, në të njëjtën Akademi, në atë vit dhe në vitin vijues, si pjesë e ekipit ndërkombëtar të trajnerëve ishte kolegu ynë Veton Sylhasi.

Në vitin 2014 KEC mori iniciativën që programin e Akademisë në nivel të Evropës Jug-lindore, ta përgatisë për shpërndarje në nivel vendor. Në vitin 2015, programi i edukimit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut u ofrua për 11 shkolla të komunës së Prishtinës, në formë të një Akademie, e cila u mbështet nga EWC dhe Këshilli i Evropës. Për katër vite me radhë programi u ofrua me mbështetjen e këtyre organizatave, si dhe Universitetit të Cyrihut për përgatitjen e mësimdhënësve (PHZH), si dhe në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ndërkohë, zhvillimet e reja në këtë fushë kanë bërë që programi të integrojë këto zhvillime dhe të shfrytëzojë burimet e reja të prodhuara, e të cilat në masë janë të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Kështu, Kuadri Referent i Kompetencave për Kulturë Demokratike (RFCDC) i Këshillit të Evropës, është një kuadër i politikave në nivel të Këshillit të Evropës që promovon kulturën demokratike, udhëhequr nga 20 kompetenca kyçe të kulturës demokratike, e njohur si “flutura e kompetencave”.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 4

Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura:

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të ndërtojnë një kulturë demokratike në udhëheqjen dhe qeverisjen e shkollave;
- Të përfshijnë parimet e EDDNj në mësimdhënie për të zhvilluar kompetencat e nxënësve të parapara me kurrikulën e Kosovës dhe në veçanti të kompetencës së qytetarisë aktive;
- Të forcojnë bashkëpunimin e shkollave me prindërit, komunitetin, institucionet dhe organizatat, në promovimin e kompetencave për kulturë demokratike;
- Të zhvillojnë dhe zbatojnë projekte shkollore që promovojnë kulturën demokratike të shkollave;
- Të prezantojnë përvojat dhe praktikat e mira në fushën e edukimit për demokraci dhe të drejta të njeriut.

Përmbajtja

Programi shfrytëzon një metodologji mikse, duke kombinuar prezantimet teorike mbi konceptet kyçe të demokracisë, edukimit për demokraci dhe kulturës demokratike, me aktivitete praktike që trajtojnë të njëjtat tema. Këto aktivitete, në masë janë aktivitete të të nxënësve përmes përvojës, kur pjesëmarrësit e përjetojnë demokracinë. Metodatat përfshijnë raste studimi, lojë me role, diskutim të çështjeve kundërtënëse, etj. Aktivitetet, rregullisht përcillen me sesione reflektimi që e përforcojnë të nxënësve.

Temat kryesore që trajtohen përfshijnë:

- Korniza dhe parimet themelore të EDDNj;
- Qasja tërëshkollore ndaj edukimit për qytetari dhe edukimit për të drejtat e njeriut (EQD/EDNj);
- Karta e Këshillit të Evropës për EDQ/EDNj dhe parimet e saj;
- Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe lidhja e saj me parimet e Kartës së Këshillit të Evropës;
- Udhëheqja demokratike e shkollave;
- Përfshirja e parimeve të EDDNj në fusha kurrikulave të ndryshme;
- Analiza procedurale dhe përmbajtësore e mësimëve model të orëve të ndryshme mësimore;
- Kutia e veglave për të nxënësve aktiv në kuadër të EDQ/EDNj;
- Njohuri për organizimin e aktiviteteve jashtë-mësimore që promovojnë zbatimin e parimeve të EDDNj;
- Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme;

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 4

- Strategjitë për zgjidhjen e konflikteve dhe të çështjeve kundërthënëse;
- Shfrytëzimi i materialeve nga ueb faqja e Këshillit të Evropës “Living Democracy”;
- Hartimi i projekteve shkollore për përmirësim të demokracisë;
- Shkëmbimi i përvojave nga zbatimi i projekteve shkollore.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet drejtorëve të shkollave, mësime dhënëse të niveleve të ndryshme, përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, prindërve dhe përfaqësuesve të tjerë të komunitetit shkollor. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësime dhënëse të ardhshëm dhe për udhëheqësit e institucioneve arsimore.

Është e pëlqyeshme që pjesëmarrja të organizohet në ekipe të vogla e të përziera shkollore (menaxhmenti i shkollës, mësime dhënëse, prindër, e pse jo edhe nxënës), në mënyrë që të zhvillohen kapacitetet e anëtarëve të ekipit bërthamë që do ta shfrytëzojnë metodologjinë e trajnimit në projekte shkollore për demokratizim të shkollës.

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi i trajnimit “Edukimi për demokracinë dhe të drejtat e njeriut” i ka 60 orë. Ai realizohet në dy faza:

Faza 1: Trajnimi 5-ditor

Trajnimi është bërthama e programit. Trajnerët dhe pjesëmarrësit punojnë së bashku dhe ndajnë përvojat e tyre me EDDNj. Pjesëmarrësit analizojnë situatën aktuale në shkollën dhe komunitetin e tyre dhe reflektojnë për praktikën e tyre në dritën e parimeve të EDDNj. Bazuar në këto analiza dhe të mbështetur nga trajnerët, secili ekip shkollor zhvillon një projekt shkollor të drejtuar kah nxitja e kulturës demokratike në shkollë.

Faza 2: Faza përcjellëse pas trajnimit

Në këtë fazë trajnerët mbështesin pjesëmarrësit (ekipet shkollore) në zbatimin e projekteve të tyre shkollore. Gjatë zbatimit të projekteve shkollore, organizohet takimi një ditë për të shkëmbyer përvojat në zbatimin e projekteve shkollore, si dhe vazhdimësinë e zbatimit të aktiviteteve që promovojnë EDDNj në shkollat përfituese të programit të trajnimit.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 4 nga 4

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 60 orë (30 orë trajnimi, 24 orë zhvillimi përmes punës në shkollë dhe 6 orë takim për prezantim të projekteve shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së programit të trajnimit;
- Dokumentimi i zbatimit të projekteve shkollë/veprimeve në shkollë të orientuara në përmirësimin e kulturës demokratike të shkollës.

Materialet e trajnimit

Në kuadër të programit do të përdoren materialet e përgatitura nga Këshilli i Evropës për zbatimin e parimeve të EDDNj në ndërtimin e një kulture demokratike në shkollë, si dhe materialet e tjera që janë zhvilluar dhe janë akredituar nga MASH-i në këtë lëmi. Në veçanti do të përdoren burimet që janë përgatitur nga Këshilli i Evropës dhe që janë përkthyer në gjuhët lokale në Kosovë. Burimet janë në dispozicion përmes ueb faqes së Këshillit të Evropës:

- Ueb faqja "Living democracy" <https://www.living-democracy.com/sq/>
- Vëllimet e Kuadrit Referent të Kompetencave për Kulturë Demokratike <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/rfcdc-volumes>
- Qeverisja demokratike e shkollave https://www.livingdemocracy.com/pdf/ext/Demgovernschools_EN.pdf
- Kompasi, manual për edukimin për të drejtat e njeriut me të rinjtë <https://www.coe.int/en/web/compass>

Ka edhe shumë materiale tjera që janë në dispozicion edhe në gjuhën shqipe, e që përdoren në trajnim. Këto materiale, më tej, janë ndihmë e madhe për palët në shkollë, që t'i përdorin në projektet e tyre shkollë dhe në aktivitetet tjera të edukimit për demokraci e të drejta të njeriut.